



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

**RAPORTI I AUDITIMIT PËR AGJENCINË E SHËRBIMEVE TË
NAVIGACIONIT AJROR
PËR VITIN FINANCIAR TË PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2018**

Prishtinë, qershor 2019

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Republikës së Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike duke ofruar bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate të audituar. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit si dhe me praktikat e mira evropiane.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror, në konsultim me Ndhmës Auditoren e Përgjithshëm Emine Fazliu, e cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Faik Thaqi (Udhëheqës ekipi) dhe Nora Rashiti Nishefci (Anëtare ekipi), nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Astrit Bllaca.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme.....	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm	6
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Qeverisja e mirë.....	15
5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	16
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	20
Shtojca II: Letërkonfirmimi.....	23
Shtojca III: Komentet e ASHNA-së në gjetjet e raportit të auditimit.....	24

Përmbledhje e përgjithshme

Raporti përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Vjetore Financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin 2018, i cili përfshin Opinionin e Auditorit të Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2018 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 23.11.2018.

Auditimi është fokusuar në:



Niveli i angazhimit për të kryer auditimin është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror.

Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i pamodifikuar me theksim të çështjes

Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2018 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale.


Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se nga kategoria e investimeve kapitale ishin buxhetuar dhe paguar 70,377€ për mallra dhe shërbime, po ashtu nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve ishin paguar 11,769€ për investime kapitale si dhe pasuritë jo financiare ishin nënvlerësuar për 41,682€.

Më gjerësisht shih pjesën 2.1 të këtij raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e opinioneve, sipas SNISA-ve.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore:



Drejtori i ASHNA-së është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit, përveç gjetjes që ndërlidhet me keq klasifikimin e shpenzimeve. Komenti i Drejtorit për çështjen që nuk është pajtuar, është dhënë në detaje në Shtojcën III.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson bashkëpunimin e menaxhmentit dhe personelit të ASHNA-së gjatë procesit të auditimit.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Auditimi përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, me sa vijon:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Nëse funksionet e kontrollit dhe të auditimit të brendshëm janë të përshtatshme dhe efikase; dhe
- Nëse janë ndërmarrë veprimet e duhura për zbatimin e rekomandimeve të auditimit.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut. Ne kemi analizuar veprimtarinë e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror (ASHNA), nivelin e mbështetjes në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë dhe që e mbështesin opinionin e AP-së.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontrolleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

Kapitujt në vijim ofrojnë përmbledhje të detajuar të gjetjeve tona të auditimit dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet për raportim të jashtëm

Auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese dhe cilësinë e saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV, përfshirë deklaratën e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i pamodifikuar me theksim të çështjes

Ne kemi audituar PFV-të e Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime) dhe Rregulloren MF, nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion

Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinion.

Theksimi i çështjes

Ne tërheqim vëmendjen tuaj për faktin se:

Sipas nenit 18 pika 3 (Inicimi i shpenzimeve) të Rregullës financiare nr. 01/2013 MF Shpenzimi i parasë publike - shpenzimet duhet të jenë në kode adekuate, të përcaktuara me Udhëzimin Administrativ për planin kontabël. Po ashtu, neni 3 i Rregullës financiare për menaxhimin e pasurisë jo financiare përcakton që - pasuri kapitale përfshihen të gjitha pasuritë që kanë afat të përdorimit më të gjatë se një vit dhe që synohet të përdoren vazhdimisht, kanë vlerë financiare 1.000€ apo më shumë dhe pronësia dhe kontrolli i përfitimeve mbetet te OB. Ne identifikuar rastet si në vijim:

- **Keq klasifikimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale** - Në tri pagesa në vlerë totale prej 83,091€¹, kemi hasur në keq klasifikim të shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale të cilat do të duhej të paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Brenda këtyre pagesave vlera prej 70,377€ nuk e përmbush kriterin për të qenë investim kapital, pasi që përfshin furnizime individuale nën 1,000€; dhe
- **Keq klasifikimi i mjeteve nga kategoria e mallra dhe shërbimeve** - Në një pagesë në vlerë prej 11,769€ për ndarjen dhe rregullimin e zyrave brenda objektit të ASHNA-së, kemi

¹ Pagesa prej 53,350.95€ për furnizim me kompjuterë dhe pajisje për sallën e mbledhjeve; pagesa prej 27,410€ për furnizim me inventar për zyre dhe pagesa prej 2,330€ për blerjen e mobileve.

hasur në keq klasifikimin e shpenzimit, pasi që kjo pagesë do të duhej të realizohej nga kategoria e investimeve kapitale.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e planifikimeve jo të sakta me rastin e përpilimit të buxhetit për projektet në fjalë.

Neni 19 pika 3 i Rreg. MF nr. 01/2017 për Raportim vjetor financiar nga Organizatat Buxhetore, përcakton që - Raportet për pasuritë që paraqiten nga organizatat buxhetore përfshijnë: pasuritë kapitale që kanë vlerë mbi 1,000€ të regjistruara në SIMFK, pasuritë jo kapitale që kanë vlerë deri 1,000€ të regjistruara në "e - pasuria" dhe stoqet.

- Pasuritë jo kapitale deri 1,000€ të vitit 2017 në vlerë prej 14,320€ si dhe ato të vitit 2018 në vlerë prej 27,362€ nuk ishin të përfshira në PVF të vitit 2018. Për këto vlera ishin nënvlerësuar pasuritë.

Opinionin jonë nuk është modifikuar për këtë çështje.

Përgjegjësia e menaxhmentit për PFV

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror dhe Zëvendës-drejtori për shërbime administrative financiare janë përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar, dhe për kontrollet e brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (me plotësime dhe ndryshime).

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ASHNA-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave të SNISA-ve, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo

gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

Nga Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (me ndryshime dhe plotësime);
- Pajtueshmërinë me Rregullat Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve (MFK);
- Planin final të Prokurimit për vitin 2018; dhe
- Raportet për obligimet e papaguara.

Marrë parasysh çka u tha më lartë, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave mund të konsiderohet e saktë, përveç çështjeve të përmendura te Theksimi i Çështjes.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Për çështjet e lartë përmendura jepet rekomandimi:

Rekomandimi A1 Drejtori duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe pasqyrimin e saktë të vlerës së pasurive jo financiare.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, kemi trajtuar menaxhimin e buxhetit, prokurimin, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

ASHNA-ja në përgjithësi kishte kontrolle të mira në raport me obligimet statusore të saj. Megjithatë ekzistojnë disa dobësi të cilat duhet të adresohen. Sfidë për institucionin edhe më tutje mbeten klasifikimi i drejtë i shpenzimeve, prezantimi i drejtë i pasurive dhe planifikimi dhe realizimi i buxhetit nga investimet kapitale. Kjo reflekton mungesë të mbikëqyrjes së duhur nga menaxhmenti në këto fusha.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore dhe shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ²	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Burimet e Fondeve:	6,844,088	5,294,846	3,729,812	3,581,634	2,928,967
Granti i Qeverisë -Buxheti	1,400,000	648,282	423,016	376,618	200,000
Të hyrat vetjake ³	3,444,088	3,447,564	3,306,796	3,205,016	2,728,967
Të hyrat e dedikuara nga AKP	2,000,000	1,199,000	0	0	0

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar ishte zvogëluar për 1,549,602€, ky zvogëlim është rezultat i vendimeve të Qeverisë⁴.

Në vitin 2018, ASHNA ka shpenzuar 70% të buxhetit final ose 3,729,812€, apo 11% më pak krahasuar me vitin paraprak. Realizimi i buxhetit mbetet në nivel jo të kënaqshëm dhe më poshtë jepen shpjegimet për pozitën aktuale.

² Buxheti Final – buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

³ Pranimet e përdorura nga entiteti për financimin e aktiviteteve vetjake.

⁴ Vendimi nr. 11/79 i datës 11.12.2018 në vlerë 801,000€, nr. 07/80 në vlerë 26,964€ dhe nr. 12/81 në vlerë 721,638€.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2018 Realizimi	2017 Realizimi	2016 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	6,844,088	5,294,846	3,729,812	3,581,634	2,928,967
Pagat dhe Mëditjet	2,539,588	2,543,064	2,543,064	2,276,854	2,200,358
Mallrat dhe Shërbimet	810,000	810,000	669,249	555,879	482,290
Shërbimet komunale	94,500	94,500	94,483	61,375	46,319
Investimet Kapitale	3,400,000	1,847,282	423,016	687,526	200,000

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Buxheti final për paga dhe mëditje ishte rritur për 3,476€ nga ai fillestar me vendim të Qeverisë. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar 100%;
- Buxheti final për mallra dhe shërbime si dhe shërbime komunale nuk kishte ndryshuar nga ai fillestar. Buxheti për mallra dhe shërbime ishte shpenzuar 83%, ndërsa ai për shërbimet komunale ishte shpenzuar rreth 100%; dhe
- Buxheti final në raport me buxhetin fillestar për investimet kapitale ishte zvogëluar për 1,552,718€ me vendime të Qeverisë. Si rezultat i këtyre vendimeve granti qeveritar ishte zvogëluar për 751,718€ si dhe fondi të hyrave të dedikuara të AKP-së prej 801,000€. Buxheti për këtë kategori është shpenzuar vetëm 423,016€ apo 23% të buxhetit final.

Çështja B1⁵ - Mos ekzekutimi i mjaftueshëm i buxhetit për investime kapitale

Gjetja Për vitin 2018, ekzekutimi i buxhetit për investime kapitale është 23% në raport me buxhetin final. Projektet të cilat ishin planifikuar që të realizohen gjatë vitit e për të cilat kontratat ishin nënshkruar në dhjetor të vitit 2018 janë: Sistemi i survejimit MSSR Mode S, rilokimi dhe azhurnimi i APP/TWR, furnizim me pjesë rezervë për PSR dhe MSSR Mode M+S.

Kjo kishte ndodhur si rezultat i alokimit të vonshëm të mjeteve nga fondi i AKP-së prej 2,000,000€ si dhe për shkak të afatit të implementimit të projekteve është mbi 6 muaj nga data e nënshkrimit të kontratave. Këto janë bartur si obligim kontraktual në vitin 2019. Kjo ka ndikuar negativisht në performancën e përgjithshme buxhetore.

Rreziku Ekzekutimi i dobët i buxhetit dhe mos realizimi i projekteve të parapara për vitin 2018 rezulton me shfrytëzim joefikas të burimeve në dispozicion dhe kjo ndikon në mos arritjen e objektivave të organizatës.

⁵ Çështja A dhe Rekomandimi A - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e reja.

Çështja B dhe Rekomandimi B - nënkupton çështjet dhe rekomandimet e përsëritura.

Çështja C dhe Rekomandimi C - nënkupton çështjet dhe rekomandimet pjesërisht të përsëritura.

Rekomandimi B1 Drejtori duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës i aktiviteteve tenderuese duke përcaktuar opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit e buxhetit para përcaktimit të programeve për vitet në vijim.

3.1.1 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ASHNA në vitin 2018 ishin në vlerë 4,001,872€. Ky nivel i inkasimit është më i lartë nga viti i kaluar për 699,214€ apo 21%. Rritja e të hyrave është si rezultat i rritjes së fluturimeve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës gjatë vitit 2018.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	2018 Pranimet	2017 Pranimet	2016 Pranimet
Të hyrat vetjake	4,001,872	3,302,654	2,705,866
Totali	4,001,872	3,302,654	2,705,866

ASHNA realizon të hyra duke ofruar shërbime të navigacionit ajror ndaj Aeroportit Ndërkombëtar "Adem Jashari" rreth 95%, si dhe në bazë të marrëveshjes me Aero kontrollin Hungarez rreth 5% e të hyrave të inkasuara për vitin 2018.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.1.2 Pagat dhe mëditjet

Pagat dhe mëditjet paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave (payrollit) që menaxhohet nga MAP dhe MF. Kontrollat kyçe që e konfirmojnë saktësinë dhe plotësinë e pagesave janë listat e pagave të nënshkruara nga udhëheqësit e njësive organizative.

Shpenzimet për paga dhe mëditje për vitin 2018 ishin 2,543,064€ apo në masën prej 100% të buxhetit final. Numri i aprovuar i të punësuarve në ASHNA ishte 166, ndërsa numri aktual i të punësuarve në fund të vitit ishte 154 punonjës.

Çështja A2 - Mangësi në procesin e rekrutimit të brendshëm

Gjetja Sipas Rregullores së Brendshme të ASHNA për përcaktimin e kritereve minimale të vendeve të punës nr. të ref: ASHNA-ZYDR-KRM dhe në bazë të konkursit të shpallur për rekrutimin e brendshëm për pozitën *Zyrtar i Prokurimit*, në kuadër të kualifikimit dhe përvojës si kriter minimal kërkohet që i përzgjedhuri të ketë shkollim universitar.

Ne kemi vërejtur se për këtë pozitë kandidati i përzgjedhuri nuk kishte shkollimin universitar të përfunduar.

Kjo kishte ndodhur si pasojë e mungesës së kontrolleve të brendshme gjatë përzgjedhjes dhe neglizhimi i anëtarëve të komisionit të vlerësimit për plotësimin e këtij kriteri.

Rreziku Mos plotësimi i kriterit minimal për pozitën e zyrtarit të prokurimit, rrit rrezikun që ASHNA punëson persona jo kompetent për pozita përkatëse. Kjo mund të rezultojë në mos efikasitet operacional dhe në mos arritje të objektivave të Organizatës.

Rekomandimi A2 Drejtori duhet të sigurojë që përzgjedhja e stafit zhvillohet sipas kriterëve të parashtruara në rregulloren e brendshme dhe konkursit duke respektuar dispozitat ligjore të shërbyesve civil.

3.1.3 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë edhe shërbimet komunale në vitin 2018 ishte 904,500€, prej tyre ishin shpenzuar 763,732 apo 84%. Këto shpenzime kanë të bëjnë me shërbime të mirëmbajtjes së Navigacionit, shërbime të tjera kontraktuese, mirëmbajtje dhe riparime, mirëmbajtje të pajisjeve, shpenzime të udhëtimit dhe akomodimit, shërbimet komunale etj.

Në bazë të testimeve tona, kemi vërejtur se kontrollet nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe mangësitë e identifikuara janë shpalosur në pjesën 2.1 Opinioni i auditimit.

3.1.4 Investimet kapitale

Buxheti final për investime kapitale ishte në vlerë prej 1,847,282€, ndërsa shpenzimet ishin vetëm 423,015€, apo shprehur në përqindje 23%. Ato kanë të bëjnë me furnizime të ndryshme të pjesëve të radarëve, sistemeve, pajisjeve të sigurisë, pajisjeve tjera, etj.

Në bazë të testimeve tona, kemi vërejtur se kontrollet nuk kanë funksionuar në mënyrë efektive dhe mangësitë e identifikuara janë shpalosur në pjesën 2.1 Opinioni i auditimit.

3.2 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Pasuria kapitale mbi 1,000€ e prezantuar në PVF ishte në vlerë 4,065,225€, pasuritë nën 1,000€ ishin në vlerën 57,100€, ndërsa stoqet 7,763€. ASHNA kishte formuar komisionin për inventarizimin dhe vlerësimin e pasurive jo financiare. Nga testimet tona identifikuam parregullsinë si në vijim:

Çështja C1 - Mos harmonizimi i regjistrave të inventarizimit me regjistrat e pasurive

Gjetja Neni 19 i rregullores nr.02/2013, përcakton që komisioni për inventarizimin e pasurisë të hartoj një raport të përgjithshëm mbi inventarizimin e pasurisë dhe të krahasoj gjendjen e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare.

Ne vërejtëm se ky komision kishte hartuar raport të përgjithshëm, por nuk kishte bërë harmonizimi në mes të regjistrave individual të inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive jo financiare, për shkak të mungesës së njohurive dhe kërkesave që dalin nga Rregullorja e Thesarit 02/2013 për pasuritë jo financiare.

Rreziku Mos harmonizimi i regjistrave të pasurisë ndikon që pasuria jo financiare t'i ekspozohet rrezikut për raportim të gabuar të vlerës së pasurisë.

Rekomandimi C1 Drejtori duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas të regjistrave të pasurive, konkretisht të harmonizojnë raportet e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive në përputhje me kërkesat rregullative.

3.3 Të arkëtueshmet

Llogaritë e arkëtueshme sipas të dhënave në PFV-të për vitin 2018 janë 602,543€, të cilat kanë të bëjnë me faturat nga koncesionari "Limak Kosovo Adem Jashari" ku sipas marrëveshjes parashihet që transferimi i mjeteve të bëhet 45 ditë pas faturimit për muajin përkatës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Obligimet e papaguara

Pasqyra e obligimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit ishte 86,858€. Këto obligime janë për shpenzimet e ndodhura pas mbylljes së afatit të pagesave për mirëmbajtje higjienike, trajnime, derivate të cilat janë bartur për t'u paguar në vitin 2019.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Qeverisja e mirë

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontroleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollat. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i listave kontrolluese të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat i dorëzohen Ministrisë së Financave.

Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentët tjerë janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkapitujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ASHNA në përgjithësi ka kontrole të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Qeverisja në ASHNA në fushën e raportimit menaxherial dhe llogaridhënies, si dhe menaxhimin e rrezikut pasqyron një situatë pozitive. Menaxhmenti i ASHNA ka ndërmarrë veprime konkrete në zbatimin e rekomandimeve të dhëna nga ZKA si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

4.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

ASHNA ka njësinë e auditimit të brendshëm (NJAB) si segment i rëndësishëm i kontroleve në përgjithësi i cili përbëhet nga Drejtori i njësisë së auditimit të brendshëm.

NJAB për 2018 kishte planifikuar shtatë auditime të rregullta, në fund të vitit ishin kryer vetëm katër auditime të cilat mbulojnë fushat si: sistemin i procedurave të prokurimit, sistemi i menaxhimit të mallrave shërbimeve dhe punëve fushëveprimi 2017/2018, si dhe menaxhimi i depos dhe menaxhimi i kontratave. Megjithatë, plani i auditimit nuk ishte përmbushur në plotësi për shkak të trajnimeve të ndryshme. Gjithashtu, NJAB ka përgatitur raporte tre mujore për aktivitetet e saj në NJQHAB në MF.

ASHNA nga fundi i vitit 2017 ka themeluar Komitetin e Auditimit i cili kishte mbajtur katër mbledhje gjatë vitit 2018.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtje e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti kishte dizajnuar një sistem të mirë të kontrollit të brendshëm dhe menaxhimit financiar. Procesi i raportimit të brendshëm në ASHNA funksionon sipas strukturës organizative. Lidhur me këtë, menaxhmenti mban takime të rregullta me të gjithë drejtuesit e departamenteve dhe ato shoqërohen me procesverbale dhe raportime të duhura për të mundësuar një përgjigje efektive dhe me kohë ndaj problemeve operative të identifikuara. Po ashtu edhe regjistri i rreziqeve ishte përgatitur nga ASHNA.

5 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2017 të ASHNA-së, ka rezultuar me 12 rekomandime. ASHNA kishte përgatitur një Plan Veprimi, ku paraqitet mënyra, se si do t'i zbatojë rekomandimet e dhëna nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2018, nëntë rekomandime janë zbatuar, një nuk është zbatuar, një është pjesërisht i zbatuar dhe një konsiderohet si i mbyllur. Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrës se si janë trajtuar ato, shihni Tabelën 4.

Tabela 4 Përmbledhja e rekomandimeve të vitit paraprak dhe vitit 2018

N r.	Fusha e Auditimit	Rekomandimet e vitit 2017	Veprimet e ndërmarra	Statusi
1	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Shpenzimi i buxhetit sipas kategorive ekonomike, nxjerr në pah një nivel relativisht të ultë të ekzekutimit të buxhetit për investimet kapitale gjatë vitit 2017. Kjo ka ndodhur për shkak se menaxhmenti nuk ka analizuar në baza të rregullta ecuritë buxhetore nga të hyrat e dedikuara kundrejt projekteve të synuara, si dhe për shkak specifikave të veçanta të projekteve të caktuara që kanë të bëjnë me veprimtarinë e ASHNA-së (shërbime navigimi), për të cilat kanë dështuar të zhvillohen procedurat e prokurimit, si për projektet 'Furnizim me sistemet e Navigacionit dhe rilakemi i sistemeve" dhe "Përditësimi i Softuerit Geo -TITAN".	Nuk janë marrë veprime të mjaftueshme nga Menaxhmenti ngase edhe këtë vit, buxheti për investime kapitale nuk ishte shpenzuar.	I pa zbatuar.
2	Pagat dhe shtesat	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që janë ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore, për zhvillimin e procedurave të rekrutimit për plotësimin e pozitave të rregullta e të cilat funksionojnë me ushtrues detyre. Më tutje, kohëzgjatja e funksionit si UD të mos jetë më e gjatë se periudha e përcaktuar ligjore.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime duke zhvilluar procedura të rekrutimit të brendshëm për mbulimin e pozitave me Ushtrues Detyre.	I zbatuar
3	Menaxhimi i personelit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që ndërmerret një shqyrtim sistematik i dosjeve të personelit, për t'u siguruar që i tërë dokumentacioni i nevojshëm të përfshihet brenda një periudhe të shkurtër kohore në dosje personale të punësuarve, duke aplikuar SIMBNJ.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë hapa lidhur me implementimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
4	Menaxhimi i personelit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që gjatë zhvillimit të procedurave për avancime të ju përmbahet kërkesave rregullative, duke ju dhënë përparësi të gjithë nëpunësve civil që i plotësojnë kriteret e nevojshme për avancim, si dhe të promovon transparencën dhe konkurrencë të hapur.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime për zbatimin e këtij rekomandimi, duke bere procedura te konkursit te brendshëm ku ne fillim te vitit 2019 ishin përfunduar si procedura te konkursit	I zbatuar

			te brendshëm (avancimit).	
5	Menaxhimi i personelit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të siguroj që të gjendet një zgjidhje e përshtatshme për plotësimin e pozitës së zyrtarit certifikues, sipas LMFP-së.	Menaxhmenti kishte bërë procedura të rekrutimit të brendshëm për pozitën e zyrtarit certifikues.	I zbatuar
6	Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë zbatohen të gjitha procedurat e kontrollit të brendshëm për qarkullim të dokumentacionit dhe faturat të protokollohen në momentin e pranimit.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime të duhura duke siguruar që të gjitha faturat janë protokolluar.	I zbatuar
7	Investimet kapitale	Drejtorin i Përgjithshëm duhet të sigurojë se procedurat e prokurimit të zhvillohen në pajtueshmëri me LPP, duke kontraktuar furnizimet në përputhje me specifikat e kërkuara me dosje të tenderit.	Menaxhmenti përmes zyrës se prokurimit kishin ndërmarrë veprime për adresimin e këtij rekomandimi.	I zbatuar
8	Investimet kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që zotimi i mjeteve të bëhet para nënshkrimit të kontratës.	Menaxhmenti përmes zyrës së financave kishin ndërmarrë veprime për adresimin e këtij rekomandimi. Asnjë kontratë e testuar nuk ishte pa zotim të mjeteve.	I zbatuar
9	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të rishikoj kontrollet ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas të regjistrave të pasurive, konkretisht të siguroj largimin e pasurive jashtë përdorimit sipas vlerësimeve të komisionit përkatës dhe të harmonizojnë raportet e vlerësimit dhe inventarizimit të cilat i paraprijnë paraqitjes së të dhënave të sakta të pasurive në PFV. Po ashtu themelimi i komisionit për vlerësim dhe inventarizim të pasurive të behet në përputhje me kërkesat rregullative.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime rreth caktimit të largimit të pasurive. Pika e dytë e rekomandimit nuk ishte implementuar, ngase edhe këtë vit nuk është bërë harmonizimi i duhur i shënimeve të regjistrave të pasurisë me regjistrat e inventarizimit. Pika e tretë e rekomandimit ishte implementuar, ngase menaxhmenti kishte caktuar anëtarë të Komisionit të inventarizimit të cilët nuk kanë kontrolle të	Pjesërisht i zbatuar

			pasurisë.	
10	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që shfrytëzuesit e automjeteve zyrtare t'u përmbahen udhëzimeve në plotësimin e fletudhëtimeve nga secili përdorues me qëllim të evidentimit të përdorimit të tyre për nevoja zyrtare.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime të duhura për implementimin e këtij rekomandimi duke evidentuar të gjitha përdorimet e veturave zyrtare.	I zbatuar
11	Obligimet e papaguara	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që të gjitha faturat e pranuar të ekzekutohen brenda afatit kohor prej 30 ditëve, për t'iu shmangur hapjes së kontesteve gjyqësore dhe ekzekutimit të pagesave direkt nga Thesari/përmbartuesit. Po ashtu obligimet e papaguara duhet të raportohen në pajtim me kërkesat rregullative.	Menaxhmenti kishte ndërmarrë veprime në implementimin e këtij rekomandimi duke paguar me kohë të gjitha obligimet e papaguara dhe raportuar me kohë në Ministri të Financave / Thesar.	I zbatuar
12	Progresi në zbatimin e rekomandimeve	Drejtori i Përgjithshëm t'i analizojë arsyet dhe shkaktarët me ndikim në mos zbatimin e rekomandimeve paraprake dhe të sigurojë përgatitjen e një plani të veprimit, i cili përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga AP, në bashkëveprim me stafin përgjegjës të angazhuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat me prioritet të lartë.		I mbyllur
N r.	Fusha e auditimit	Rekomandimet e vitit 2018		
1	Pasqyrat Financiare Vjetore	Drejtori duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes, duke ndërmarrë veprime specifike për t'i eliminuar gabimet në klasifikimin e shpenzimeve dhe pasqyrimin e saktë të vlerës së pasurive jo financiare.		
2	Planifikimi dhe realizimi i buxhetit	Drejtori duhet të sigurojë që të bëhet një vlerësim gjithëpërfshirës, të përcaktoj opsione praktike për përmirësimin e ekzekutimit të buxhetit dhe të adresohen shkaqet për mos realizimin e buxhetit në nivel të planifikuar.		
3	Pagat dhe mëditjet	Drejtori duhet që sigurojë që procedurat e rekrutimit të stafit të zhvillohen konform kritereve të parashtruara në rregulloren e brendshme dhe konkurs duke respektuar dispozitat ligjore të shërbyesve civil.		
4.	Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale	Drejtori duhet të rishikoj kontrollat ekzistuese për të siguruar menaxhim efikas të regjistrave të pasurive, konkretisht të harmonizojnë raportet e inventarizimit me gjendjen në regjistrat e pasurive në përputhje me kërkesat rregullative.		

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keq-deklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keq deklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keq deklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keq deklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragrafi të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Letërkonfirmimi

**ASHNA**

Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror
 Agencija za Vazdušno Navigacijske Usluge
 Air Navigation Services Agency

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2018 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Pasqyrave Financiare të Agjencisë së Shërbimeve të Navigacionit Ajror për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2018 (në tekstin e mëtejshëm "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat, rekomandimet dhe përmbajtjen e Raportit, përveç të gjeturës të Theksimi i Çështjes për të cilën i kemi bashkangjitur komentet e mospajtimit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

z. Bahri Nuredini

Drejtor - Agjencia e Shërbimeve të Navigacionit Ajror

Data: 24.06.2019, Prishtinë,

Shtojca III: Komentet e ASHNA-së në gjetjet e raportit të auditimit

Gjetjet/Çështjet	Pajt ohe mi po/ jo	Komentet e OB-së në rast të mospajtimit	Pikëpamjet e ZKA-së
<p>Çështja 1:</p> <p>Theksimi i çështjës,</p> <ul style="list-style-type: none"> - Keq klasifikimi i mjeteve nga kategoria e investimeve kapitale, Në tri pagesa në vlerë totale prej 83,090.95€, kemi hasur në keq klasifikim të shpenzimeve nga kategoria e investimeve kapitale të cilat do të duhej të paguhen nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve. Brenda këtyre pagesave vlera prej 70,377€ nuk përmbush kriterin për të qenë investim kapital, pasi që përfshin furnizime individuale nën 1,000€; dhe - Keq klasifikimi i mjeteve nga kategoria e mallra dhe shërbimeve në një pagesë në vlerë prej 11,769€ për ndarjen dhe rregullimin e zyrave brenda objektit të ASHNA-së, kemi hasur në keq klasifikimin e shpenzimit, pasi që kjo pagesë do të duhej të realizohej nga kategoria e investimeve kapitale. 	Jo	<p>1.1 Planifikimi buxhetor për këtë investim kapital është bërë me vlerë mbi një mijë euro dhe kemi aprovim të bugjetit me këtë vlerë, si dhe duke u bazuar edhe në hulumtimin e tregut për blerje të kompjuterëve me një performancë më të lartë dhe pajisjeve tjera pasi që sistemet ekzistuese kërkojnë një performancë më të lartë të pajisjeve kompjuterike ku në këtë pagesë prej 53,350.95 për furnizim me kompjuter dhe pajisje tjera janë pajisje të cilat ndërlidhen me sistemet ekzistuese.</p> <p>Gjithashtu pritjet në të ardhmen e afërt janë që sistemi i ri i ATM (Menaxhimit të Trafikut Ajror) i cili do të instalohet në ASHNA kërkon që pajisjet të jenë me performanca të larta si në procesim të dhënave (Database processing, Flight DataProcessing, Aeronautical Flight Telecommunication Network), komunikim, sisteme meteorologjike, të kontrollit të trafikut ajror (Sistemi Geotitan – i cili kërkon një procesim të lartë të imazheve) etj. Pajisjet e kërkuara ndihmojnë në arritjen e sigurt dhe më të lehtë të standardeve të caktuara nga Eurocontrol ku ne synojmë të arrijmë.</p> <p>Në këtë çështje, mungesa e ndonjë rregullativi i cili mundëson trajtimin-rregullimin e shpenzimeve(transaksioneve) të tilla në kalsifikim të shpenzimeve nga kapitalet në Mallra & Shërbime si dhe anasjelltas gjë që pamundëson që të bëhet ndryshim në planifikimin buxhetor të aprovuar pas ndodhjes së shpenzimit. (Udhëzimi Administrativ 2005/08</p>	<p>Çështja është theksuar për gabimet në planifikimin dhe shpenzimin e buxhetit për këtë kategori. Komenti i dhënë nga Menaxhmenti i ASHNA-së nuk e ndryshon gjendjen për shpenzimet e keq klasifikuara. Prandaj rekomandimi mbetet i pandryshuar.</p>

<p>- Pasurit jo kapitale deri 1,000€ të vitit 2017 në vlerë prej 14,320€ si dhe pasuritë kapitale 1,000€ të vitit 2018 prej 27,362€ nuk ishin të përfshira në PVF të vitit 2018. Pë këto vlera ishin nënvlerësuar pasurit., vlera ne PVF te vitit 2018 ishin të nënvlerësuar.</p>		Klasifikimi ekonomik i shpenzimeve.)	
---	--	--------------------------------------	--